

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

FTESË PËR OFERTË

- 1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë, Adresa: Rr. Abdi Toptani, Nr.1, Tiranë, Shqipëri.
- 2. Emri dhe adresa e personit të kontaktit:** Z. Antonio Bushati, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
E-mail: antonio.bushati@infrastruktura.gov.al;
Për dijeni: gjergji.simaku@infrastruktura.gov.al;
- 3. Forma, objekti dhe lloji i kontraktimit:** Përzgjedhja e ofertuesit për projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një Impianti Fotovoltaik për gjenerimin e energjisë elektrike, në zonën Remas - Karavasta, Lushnjë dhe Libofshë, Fier, me një kapacitet të instaluar 70 MWp si pjesë e masave mbështetëse, dhe me një kapacitet shtesë të instaluar prej 70MWp, i cili nuk do të jetë pjesë e Masave Mbështetëse (gjithsej 140 MWp kapacitetit të instaluar), (Projekti).
- 4. Lloji i Procesit Konkurrues:** Procedurë e hapur.
- 5. Vendndodhja e Projektit:** Impianti Fotovoltaik do të ketë vendodhjen në Zonën e Karavastasë, Remas - Karavasta Lushnjë, Libofshë -Fier, Shqipëri.
- 6. Kohëzgjatja e Marrëveshjes së Zhvillimit të Projektit:** 30 vjet (sipas specifikimeve të parashikuara në Dokumentet e Procesit Konkurrues).
- 7. Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike:** Si pjesë e masave mbështetëse, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike do të nënshkruhet për një kapacitet blerjeje 70 MWp, për një afat prej 15 vjetësh.
- 8. Afati për Dorëzimin e Ofertave:** 16 Mars 2020, ora 12.00 (Ora e Evropës Qendrore).
- 9. Hapja e Ofertave:** 16 Mars 2020, ora 12.00 (Ora e Evropës Qendrore).
- 10. Periudha e vlefshmërisë së ofertës:** Ofertat duhet të jenë të vlefshme për një periudhë 180 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
- 11. Sigurimi i ofertës:** Garancia e ofertës, në shumën prej 560,000 Euro (Pesëqind e gjashtëdhjetë mijë EURO), e lëshuar nga një bankë me reputacion, duhet të jetë e vlefshme për një periudhë prej 180 ditësh nga Afati për Dorëzimin e Ofertave.
- 12. Blerja e Dokumenteve të Procesit Konkurrues:** Dokumentet e Procesit Konkurrues mund të blihen duke filluar nga data 20 Janar 2020, kundrejt pagesës prej 2,000 Euro (Dy mijë Euro).
- 13. Pranimi dhe vlerësimi i ofertës:** Sipas përcaktimeve në Dokumentet e Procesit Konkurrues.